

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.A. nga fsh. ..., Komuna e Deçanit, për shkak të veprës penale dhënia e rryshfetit nga neni 429 par. 1 të KPK-së, duke vendosur për ankesën e të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.266/2016 të dt. 26.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, me datë 21.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit N.A., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.266/2016 të dt. 26.09.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.266/2016 të dt. 26.09.2018, e ka shpallur fajtor të akuzuarin N.A., për shkak të veprës penale dhënia e rryshfetit nga neni 429 par. 1 të KPK-së, dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim do ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgu, ashtu që për një ditë burgim do t'i llogaritet shuma prej 20 €.

Të akuzuarit i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, ashtu që nga i akuzuari ka konfiskuar kartëmonedha në vlerë prej 10 (dhjetë) €, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Të akuzuarin e ka detyruar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) €, si dhe në emër të Fondit për kompensimin e Viktimave të Krimit, shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

I akuzuari N.A., për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, pa informimin e palëve, ngase, në rastin konkret me aktgjykimin e ankimuar nuk është shqiptuar dënim me burgim, prandaj, nuk ka bazë ligjore për informim të obligueshëm të palëve.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.492/2018, të dt. 23.10.2018, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Me ankesën e të akuzuarit N.A., aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, pasi që i akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë – neni 383 par. 2 të KPPK, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Në ankesën e të akuzuarit, përkitazi me këtë bazë ankimore theksohet se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, edhe ashtu nuk është aq i lartë, mirëpo, duke marrë për bazë gjendjen ekonomike, atëherë konstaton se dënimi i shqiptuar është i ashpër, ngase, gjendja ekonomike e të akuzuarit është e rëndë, i njëjti realizon të ardhura shumë të vogla, e duke marrë parasysh faktin se askush tjetër nuk punon nga familja, ndërsa, i njëjti është mbajtës i bashkëshortes dhe dy fëmijëve të vegjël të moshës 7 dhe 5 vjeçare, atëherë edhe dënimi i shqiptuar me gjobë ia vështirëson edhe më shumë gjendjen materiale, për çka, propozon ndryshimin e aktgjykimit dhe shqiptimin e një dënimi më të butë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parasheh dispozita e nenit 73 të KPK-së, ashtu që pasi më parë i ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese si sjelljen e mirë të akuzuarit, pranimin e fajësisë dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar, kurse, përkitazi me rrethanat rënduese ka konstatuar se nuk ka gjetur dhe i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Pretendimet e të akuzuarit, nuk janë të bazuara ngase, rrethanat të cilat ceken me ankesë, vetëm konstatohen në mënyrë paushallë por me asnjë provë të vetme në shkresat e lëndës nuk argumentohet në kuptim të asaj që të vërtetohet se me të vërtetë i akuzuari e ka gjendjen e rëndë ekonomike, që do të thotë se i akuzuari në rastin konkret nuk ka ofruar asnjë rrethanë tjetër lehtësuese nga ato që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë, kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin me gjobë, në shumë prej 200 €.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e konstatuara në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, e sidomos faktin se i akuzuari punon dhe jeton në Gjermani, atëherë, rezulton se dënimin të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit, pra, dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, është i drejtë, dhe i ligjshëm, po ashtu, i njëjti është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.518/2018, të datës 21.11.2018

Procesmbajtësja,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,

1. Xhevdet Abazi

2. Afrim Shala

Kryetari i kolegjit,
Abdullah Ahmeti